



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Planuar / Dorezuar Prijmjeño/Prodato Received / Delivery	09 - 11 2022 2	viti god year	
Organ / Njësia Organ / Jedinica Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKMESHCK	6920/2022		114



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA**  
**INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO**

A.nr.794/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për shqyrtimin e ankesave i përbërë nga: Malsore Gashi Bajraktari - kryetare, Arben Mehmet dhe Eshref Shabani-anëtar, si dhe Zyle Millaku Gojnovci - Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.794/2022 të datës 12.09.2022 të parashtruar për mes postës elektronike: ankesa.KPMSHCK@rks-gov.net, nga \_\_\_\_\_ nga kundër organit të punësimit Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, çështjen juridike “*kërkesa nga marrëdhënia e punës*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr.03/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 09.11.2022, mori këtë:

**V E N D I M**

**HEDHET poshtë si e palejuar ankesa me numër A.nr.794/2022 e datës 12.09.2022 e parashtruar nga ankuesi**

**A r s y e t i m**

Ankues \_\_\_\_\_ i cili sipas shkresave të lëndës është i punësuar në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, ka parashtruar ankesë me datë 12.09.2022 në Këshillin i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës kundër Vendimit me Nr.464/2022 të datës 20.07.2022 i nxjerrë nga Ministria e Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshill pretendon se Vendimi me Nr.484/2022 i datës 20.07.2022 i nxjerrë nga Ministria e Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës është i kundërligjshëm me kërkesën që Këshilli ta anulojë të njëjtin për shkak të paligshmërisë së tij, ndërsa ankuesit t’ia njoh të drejtën për emrim në shërbimin diplomatik në Dhaka-Bangladesh sikurse ka rekomanduar Komisioni i Rrotacionit sipas raportit të datës 25.02.2022.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil më datë 15.09.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankueses në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës. Më datë 20.09.2022 ka pranuar përgjigje në ankesë nga Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, se bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës, e plotësuar me prova shtesë të datës 20.10.2022 sipas kërkesë së KPMSHCK-së.

Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me datën 25.10.2022 ka nxjerr vendimin VK.nr.132/2022 për shtyrje të afatit edhe për 10 (dhjetë) ditë punë të ankesës A.nr.794/2022 të datës 12.09.2022.

**Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka administruar këto prova:** Ankesë e datës 12.09.2022 e ankuesit Anr.794/2022 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me numër protokolli: 5315/2022 e përmes emalit zyrtar: [ankes.KPMSHCK@rks-gov.net](mailto:ankes.KPMSHCK@rks-gov.net); Shpallje shprehjes së Interesit nr. Ref/08/2022 datës 08.02.2022; E-mail i datës 02.08.2022; Kërkesë e datës 10.02.2022 nga ankuesi për shprehje të interesit për pozitat vakante në mision diplomatik/konsullor në Republikë; CV-Biografia e ankuesit; Letër motivuese e datës 10.02.2022 nga ankuesi; Certifikatë e datës 16.02.2018; Certifikatë e datës 20.02.2017; Formular i Vlerësimit për nëpunësit e shërbimit të jashtëm për vitin 2021; Formular i Vlerësimit për nëpunësit e shërbimit të jashtëm për vitin 2019; Formular i Vlerësimit për nëpunësit e shërbimit të jashtëm për vitin 2018; Udhëzim konsultim mjekësor i datës 25.10.2021, raport mjekësor i datës 05.12.2021 ; E-mail i datës 02.11.2022 nga ankuesi lidhur me kërkesa të bashkangjitur, listën mbi rekomandimin e ankuesit në mision diplomatit për rotacion; E-mail i datës 08.01.2022 nga z.A.R, për ankuesin lidhur për qasje në dokumente zyrtare; E-maili i datës 25.07.2022 nga ankuesi drejtuar z.A.R, për qasje në dokumente zyrtare; Kërkesë e datës 25.07.2022 për qasje në dokumente zyrtare me nr. Ref. DFSHP-DLSH-2022; E-mail i datës 25.07.2022 nga ankuesi drejtuar z.A.R; Kërkesë e datës 01.08.2022 për qasje në dokumente zyrtare me nr. Ref. DFSHP-DLSH-2022; E-mail i datës 08.01.2022 drejtuar z.A.R; Kërkesë e datës 02.09.2022 për qasje në dokumente zyrtare me nr. Ref. DFSHP-DLSH-2022; E-mail i datës 09.02.2022 drejtuar z.A.R; E-mail i datës 12.09.2022 drejtuar z.A.R, z.J.A, z.V.K, znj.K.S.D për Agjencinë për Informim dhe Privatësi; Përgjigje në ankesë e datës 20.09.2022 me nr. protokolli 5528/2022 nga Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës me shkresat e bashkangjitura, Akte emërimi i ankuesit i datës 13.06.2022; E-mail i datës 08.02.2022 nga zyra e Sekretarit të MPJD; E-mail i datës 20.10.2022 nga Njësia e Burimeve Njerëzore të MPJD, për prova shtesë, të bashkangjitura Vendimin me numër ref.71/2022 i datës 16.02.2022 për themelimin e komisionit për rotacioni nxjerrë nga Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës; Vendimi nr. Ref.464/2022 i datës 20.07.2022 i Zëvendëskryeminstres dhe Ministres së Punëve të Jashtme dhe Diasporës; E-maili datës 20.10.2022 lista e vlerësuesve të rotacionit shkurt 2022, me listën e bashkangjitur prej 1/15 faqe; Raporti i komisionit për rotacioni i datës 25.02.2022 prej 1/22 faqe.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar dhe analizuar provat e lëndës të parashruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa e ankuesit *është e palejuar, sepse:*

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, nga amdinistrimi i shkresave të lëndës, repsketivisht sipas Aktit të Emërimit të datë 13.06.2022 ka konstatuar se ankuesi është i punësuar në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës në pozitën "Zyrtar i Lartë për Logjistike", në kuadër të Departamentit për Shërbime të Përgjithshme /Divizioni për Logjistik dhe Shërbime, i cili me datë 10.02.2022 ka aplikuar në shpalljen e datës 08.02.2022 të publikuar nga Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës për shprehje të interesit për pozita të lira në misionet diplomatike të Republikës së Kosovës, për tri (3)pozitat si në vijim: *Kanberra-Australi, në Dhaka-Bangladesh dhe në Daka-Senegal.*

Po ashtu, nga shkresat e lëndës Kolegji i Këshillit ka konstatuar se Komisioni për Rotacion me datë 25.02.2022 ka nxjerrë Raportin për vlerësimin e përmbushjes së kriterëve të përcaktuara në shpalljen e interesit të datës 08.02.2022, në të cilin raport ankuesi me gradë diplomatike Sekretari I,



rekomandohet për misionin diplomatik në Amabdasadën e Republikës së Kosovës në Dhaka-Bangladesh, bazuar në shpalljen e interesit të datës 08.02.2022 me numër protokoli:349 dhe numër reference:08/2022 për pozitat e lira për misione diplomatike dhe konsullore, nga rrjedh se Komisioni për Rrotacion i cili ishte themeluar sipas Vendimit me Nr.71/2022 të datës 16.02.2022 nga Ministra e Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, e kishin marr paraysh shprehjen e interesit të ankuesit të datës 10.02.2022.

Me rastin e analizimit të Vendimit me Nr.464/2022 të 20.07.2022 i nxjerrë nga Ministria e Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, përmes të cilit z. Kluna "Zyrtar i Lartë për Viza", i njihet gradë në shërbimin diplomatik si Zëvendëskonsull, në barasvlerë me gradën Sekretar i III, dhe caktohet që të shërbejë në Ambasadën e Republikës së Kosovës në Dhaka/Republika Popullore Bangladesh, duke filluar nga data 01.08.2022, Kolegji i Këshillit ka gjetur se në fakt gradë është miratuar pas konfirmimit për dhënien e gradave nga Komisioni për Gradë dhe Disiplinë, funksion ky i caktuar në dispozitën ligjore të nenit 14 paragrafit 2 dhe 3 të Rregullores Nr.02/2009 për Shërbimin e Jashtëm, citoj: *"Komisioni takohet me kërkesë të kryesuesit, që të konfirmoj dhënien e gradimeve sipas meritave dhe rritjes së shkallës (gradës) së brendshme që rezultojnë pas shqyrtimit për vlerësimin e rezultateve në punës, siç përcaktohet në këtë Rregullore"* dhe *"Rezultatet e konfirmimit të Komisioni për gradave raportohen te Ministri, i cili duhet të miratojë vendimet përfundimtare të dhëna në paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni"*, dhe mbi këtë bazë konstatohet fakti se caktimi i zyrtarit që të shërbejë në misionin diplomatik në pozitën *"Zëvendës Konsull, i barasvlerës së gradës Sekretar i III"* në Ambasadën e Republikës së Kosovës në Dhaka/Republika Popullore Bangladesh nuk ka ndërlidhje me pozitën e cila është përcaktuar në Raportin e hartuar nga Komisioni i Rotacionit ndërlidhur me rekomandimin e ankuesit sipas shpalljes së interesit të datës 08.02.2022 me numër protokoli:349 dhe numër reference:08/2022 për pozitat e lira për misione diplomatike dhe konsullore, respektivisht pozita në të cilën ankuesi është rekomanduar kanë qenë *"Gradë nga Atashe deri Sekretar i Parë"*.

Ndërlidhur si më lartë, Kolegji i Këshillit në vështrim të dispozitave të nenit 24 paragrafi 3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë konstaton se çdo nëpunës civil ka të drejtë të paraqesë ankesë drejtpërdrejt në KPMSHC për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto, që burojnë nga marrëdhënia e punës. Andaj, në këtë kuptim si dhe referuar nenit 124 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: *"Pala ka të drejtë të ushtrojë mjetet juridike administrative ndaj çdo veprimi apo mosveprimi administrativ, nëse pretendon se të drejtat apo interesat e saj juridike cenohen nga ky veprim apo mosveprim..."*, Kolegji i Këshillit vlerëson se me Vendimin me Nr.464/2022 të 20.07.2022 i nxjerrë nga Ministria e Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, nuk është cenuar ndonjë e drejtë apo interes juridik i ankuesit i cili është i përcaktuar në mënyrë specifike lidhur me marrëdhënien e tij të punës, andaj bazuar në këtë konstatim si dhe në mbështetje të nenit 129 paragrafi 1 nen paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, rrjedhë se ankesa A.nr.794/2022 e datës 12.09.2022 e parashtruar nga ankuesi është e paqëndrueshme dhe si e tillë hedhet poshtë si në dispozitiv të këtij vendimi, ndërsa sa i përket pretendimit ankimor të ankuesit që Këshill të detyrojë Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës t'ia njoh drejtën për emrim në shërbimin diplomatik në Dhaka-Bangladesh sikurse ka rekomanduar Komisioni i Rrotacionit sipas raportit të datës 25.02.2022, Kolegji i Këshillit thekson faktin se nga administrim i provava të ofruar nga palët nuk ka arritur të gjej apo konstatoj se cila është data obligative apo afati kohor brenda së cilës institucioni punëdhënës ankuesin duhet të caktohet në shërbimin diplomatik sipas raportit të Komisionit të Rotacionit i datës 25.02.2022,

andaj vlerësojmë ky është proces është në zhvillim e sipër dhe se këtë pretendim nuk mund të vlerësojmë si të bazuar.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar ne nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafin 1.1 si dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë - Departamentin Administrativ, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIQYRËS PËR SHËRBYMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda me numër A.nr.794/2022.

Zyle Millaku GOJNOVCI

Procesmbajtëse

Malsore Gashi BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

**Vendimi i dërgohet:**

- Ankuesit
- Ministrit të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës
- Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës,
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës,
- Arkivit të KPMSHCK-së